



Dalës-Izleazna

Nr. 11-908
Br.

Data 27.08.2019
Datum

OBILIQ-OBILIĆ



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO - KOMUNA E OBILIQIT-KOSOVË / OPŠTINA OBILIĆ - KOSOVO / MUNICIPALITY OF OBILIQ - KOSOVO

Në mbështetje të nenit 11 Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës Kosovës , Rregulloren 02/2010 Procedura e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Obiliqit me datën 27.08.2019, shpall:

KONKURS

Pozita: Inspektor i ndërtimit ,
Lokacioni/ vendi i punës: Komuna e Obiliqit, Drejtorja e inspektionit,
Paga mujore: 423.57 €, koeficienti 7.
Kontrata : I karrierës,
Periudhë provuese : 12 muaj.

Detyrat kyçe:

- Inspektori i ndërtimit zbaton Ligjin e ndërtimit dhe te gjitha rregulloret dhe aktet normative të nxjerra nga ligji i ndërtimit.
- Inspektori i ndërtimit ka autorizim për të inspektuar ndërtesën gjatë gjithë kohës së ndërtimit dhe si dhe pas përfundimit të objektit për të siguruar respektimin e ligjit. Inspektori gjithashtu ka për detyrë të kontrolloj shtrirjen dhe etazhitetin e objektit ndërtimor në harmoni me projektin.
- Inspektori ka autorizim të marrë pjesë gjatë testimit të produkteve të ndërtimit, si dhe testimit të pjesëve të elementeve strukturore të parafabrikuara për inspektim për çdo ndërtim.
- Inspektori është i autorizuar të hyjë në prona, përfshirë këtu edhe banesat, gjatë kryerjes së inspektionit. Për këtë qëllim, inspektori është i obliguar që të ruaj paprekshmërinë e banesës.
- Pjesëmarrësit në ndërtim janë të obliguar të ndihmojnë inspektorin në kryerjen e inspektionit dhe mbikëqyrjes përkatëse, veçanërisht inspektionin e objekteve ndërtimore ekzistuese ose objekteve në ndërtim sipër si dhe shqyrtimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm
- Inspektori mban evidencë të kryerjes së inspektionit dhe detyrave tjera në procesverbalin e kryerjes së inspektionit
- Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkohen kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Shkathtësitë, kualifikimi:

- Diplomë universitare, drejtimi ndërtimtari, arkitekturë, juridik, ekonomik ;
- Tri vite përvojë pune
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit)

Të interesuarit aplikacionit duhet t'ia bashkëngjisnin këto dokumente – kopjen e diplomës arsimore , **nëse përgatitja shkollë - diploma është nga shtetet tjera duhet të verifikohet në Ministrinë e Arsimit**, dëshmi për përvojën e punës, kopjen e letërnjoftimit.

Gjatë procedurës së shqyrtimit të aplikacioneve, Komisioni mund të verifikojë me institucionet përkatëse vërtetësinë e të dhënave të siguruar nga kandidatët.

Kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacionin me të dhëna të sakta . Në rast të mosplotësimit të këtyre kërkesave ose ofrimit të informativ të rrejshme, aplikacioni refuzohet.

Aplikacionet e kandidatëve të cilët kanë dosje personale kriminale, e cila , sipas Ligjit për Shërbimin Civil konsiderohet e pa përshtatshme për emërim në Shërbimin Civil, do të refuzohet.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrën për shërbim me qytetar. Afati për paraqitjen e aplikacioneve është 15 ditë nga data e publikimit . Dokumentet e pa kompletuar dhe të arritura pas afatit nuk do të merren në shqyrtim. Kandidatët të cilët hyjnë në listën e ngushtë do të njoftohen për intervistë përmes tabelës së shpalljeve dhe telefonit. Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabartë të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitete në Kosovë.

Kryetar i Komunës


Xhafer Gashi

